



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 661 Prot.

Tiranë, më 08.05 2019

VENDIM Nr. 96, datë 2.05.2019

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 5, datë 2.05.2019, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të objektit "**Projekti i zgjerimit të rrjetit lokal në Ksamil**"-subjekti ALBtelecom sh.a., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Neritan Ceka,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të objektit "**Projekti i zgjerimit të rrjetit lokal në Ksamil**"-subjekti ALBtelecom sh.a., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Neritan Ceka.
2. Subjekti ALBtelecom sh.a., duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për objektin "Projekti i zgjerimit të rrjetit lokal në Ksamil", si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al